

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 23.06.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Pandi Bello deri në momentin e zgjedhjes së Kryetari të Këshillit

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 39

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 39

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 1

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

Sekretare E.Naçi: Në cilësinë e sekretares së K.B kam nderin dhe privilegjin të çel sot këtë mbledhje të parë të konstituimit të Këshillit Bashkiak dalë nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendor të datës 14.05.2023. Si fillim do të përshëndes prezencën, përfaqësuesit e qeverisë, prefektin Z.Nertil Jole, si dhe kryetarin e Këshillit të Qarkut Z.Ana Verushi, të gjithë këshilltarët e rinj të sapo zgjedhur, përfaqësuesit e mediave, dhe të gjithë të pranishmit e tjerë që janë në sallë. Një falenderim shkon për 41 këshilltarët që sapo mbyllën mandatin e tyre. Një falenderim i vecantë shkon për kryetarin e Këshillit Bashkiak Z.Erjon Nexhipi. Përpara se të vazhdoj me pikën e 1 të rendit të ditë do të vazhdoj me leximin e emrave të këshilltarëve të rinj për të verifikuar prezencën dhe për tu njohur me njëri-tjetrin. Ligji për vetëqeverisjen vendore nr.139, 2015 përkatësisht në nenin 48 në pikën 5 në mbledhjen e parë të këshillit deri në zgjedhjen e kryetarit të tij del këshilltari më i vjetër në moshë. Këshilltari më i vjetër në moshë është z.Pandi Bello.

Këshilltar P.Bello: Vazhdojmë me rendin e ditës. Fillojmë me konstituimin e Këshillit Bashkiak dhe me rradhë.

Sekretare E.Naçi: Nuk e di nëse kemi nga grupet të cilat i dimë që janë të konsoliduara sic është partia Socialiste për momentin dhe Bashkë Fitojmë, nëse keni zgjedhur ndonjë kryetar grupi, sepse kryetari i grupit është ai që flet në emër të grupit dhe bën edhe propozimet.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ju uroj të gjithë këshilltarëve punë të mbarë në këtë mandate 4 vjecar i cili shpresoj dhe uroj që do të jetë një mandat i shndërrimit të Korcës në një tjetër nivel nga cfarë është sot. Unë në emër të partisë socialiste dua të propozoj si anëtarë të komisionit të vërtetimit të mandateve z.Emiljano Muharrem dhe z.Lamberto Malaveci.

Këshilltar D.Osmani: Ne si grup propozojmë znj.Jorida Romacka si anëtare e verifikimit të mandateve.

Sekretare E.Naçi: Hidhet në votim numri i komisionit të mandatave që janë 3 anëtarë dhe emrat që janë propozuar.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 39

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretare E.Naçi:Ftojme komisionin e mandateve te vijë përpara. Si fillim do zgjidhni një kryetar dhe një sekretar.

Këshilltar E.Muharrem: Suksese dhe punë të mbarë të gjithve në këtë mandate 4 vjecar. Komisioni i mandateve i përbërë nga Jorida Romacka, Emiljano Muharrem, Llamberto Malaveci vendosi kryetari i komisionit E.Muharrem, sekretare J.Romacka dhe anëtar Llamberto Malaveci. Ashtu sikundër e tha dhe sekretarja e K.B pasi lexoi vendimin e KQZ i cili ka shpërndarë mandatet e këshilltarëve sipas subjekteve politike si më poshtë: subjekti Bashkë Fitojmë 9 mandate, Partia Socialiste e Shqipërisë 23 mandate, Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 2 mandate, Partia Republikane e Shqipërisë 1 mandat, Partia Social Demokrate 1 mandat, Partia Demokratike 2 mandate, Aleanca Arbnore Kombëtare 1 mandat, Nisma Thurrje 1 mandat dhe këshilltari Lazjon Petri i cili është nga shoqëria civile. Vazhdojmë me procedurën e verifikimit të mandateve ku të gjithë këshilltarët do të paraqiten sipas listës emërore me kartën e ID të tyre. Komisioni i mandateve pasi verifikoi listën e këshilltarëve konstatoi se në mbledhje marrin pjesë 39 anëtarë, nuk marrin pjesë 2 anëtarë të këshillit. Vërtetohet vlefshëmria e mandateve e 39 anëtarëve. Nuk vërtetohen për momentin 2 anëtarë pasi për arsye mungese do të verifikohen në mbledhjen e rradhës që do të vijë. Anëtarët të cilët sot mungojnë janë Erjols Haxhillari dhe Irvin Bode. Komisioni i verifikimit të mandateve i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë 39 mandatet e anëtarëve pasi dokumentacioni i tyre është i saktë.

Sekretare E.Naci: Hedhim në votim procesverbalin dhe kjo që na u lexua nga komisioni i mandateve. 39 mandatet e këshilltarëve të verifikuara nga komisioni i mandateve.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 39

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretare E.Naçi: Pasi mandatet u miratuan nga këshilli kalojmë tek akti i betimit. E bëjmë nominale sipas ligjit.

Këshilltar P.Bello: Po cilësoj formulën e betimit: Betohe në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do ti bindem kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interes e shtetasve të bashkisë Korçë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirqënies së tyre. Betohe!

Të gjithë këshilltarët vazhdojnë aktin e betimit.

Këshilltar P.Bello: Vazhdojmë me ngritjen e komisionit të votimit. Në këtë komision duhet të jenë 3 anëtarë. Fillojmë me propozimet dhe më pas me votimin.

Këshilltar P.Tollkuçi: Në emër të Partisë Socialiste propozoj 2 kandidatura për komisionin e votimit për votimet që do të kryhen sot, të cilët janë Kostika Zguri dhe Altin Habip.

Këshilltar D.Osmani: Përsëri Joridën.

Sekretare E.Naçi: Kalojmë si fillim në votim numrin e anëtarëve të komisionit dhe emrat të cilat u propozuan.

Hidhet në votim dhe miratohet

Këshilltar P.Tollkuçi: Në emër të grupit të Partisë Socialiste unë propozoj për kandidatë për kryetare të Këshillit Bashkiak zonjën Ana Verushi. Të flasësh për Ana Verushin nuk është e lehtë pasi është një zonjë e nderuar e këtij qyteti, mbasi dhe të flasësh shumë gabon pasi vetë prania e saj në këtë sallë punët që ajo ka kryer dhe funksionet e ndryshme që ajo ka kryer në funksion të këtij qyteti flasin vetë.

Këshilltar D.Osmani: Në emër të koalicionit Bashkë Fitojmë ne nuk kemi propozim.

Këshilltar L.Petri: Për hir të procedurës mendoj se është më e hijshme dhe ligjore që mos ketë vetëm një kandidat për kryetarin e këshillit dhe unë në emër të shoqërisë civile po propozoj Klajdi Pllaha për të qënë kandidat për kryetar të këshillit bashkiak për këtë mandate dhe Klajdi Pllaha vjen nga një familje shumë e nderuar qytetare dhe mendoj se i ka të gjitha cilësitë për të bërë moderimin e duhur siç e kërkon kjo detyrë.

Këshilltar K.Pllaha: Faleminderit për konsideratën Lazjon por nuk e pranoj kandidimin.

Sekretare E.Naci: Vazhdojmë me procedurën e votimit. Votimi bëhet në mënyrë të fshehtë. Pasi ka mbaruar procesi i votimit, fillon procesi i numërimit. Votat numërohen nga anëtarët e komisionit të votimit. Numërimi është transparent.

Vota PRO 33

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 3

Këshilltar P.Bello: Në bazë të rezultatit të votimit Ana Verushi është kryetare e Këshillit Bashkiak dhe fillon që në këtë moment të drejtojë punën e Këshillit të Bashkisë.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Shpreh falenderimet e saj. Vazhdojmë përsëri me rendin e ditës zgjedhja e Zëvendëskryetarit/rëve të Këshillit. Do të doja që nga subjektet politikie të propozohet numri i kandidatëve për zëvendëskryetarë të Këshillit Bashkiak dhe më pas për administrimin e kandidaturave të secilave subjekte politike.

Këshilltar P.Tollkuçi: Në emër të Partisë Socialiste propozoj që ky Këshill të ketë 3 zëvendëskryetarë.

Këshilltar D.Osmani: Edhe ne jemi të mendimit që të ketë 3 zëvendëskryetarë.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 38

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Kërkoj nga subjektet emrat për kandidimin e zëvendëskryetarëve.

Këshilltar P.Tollkuci: Në emër të partisë Socialiste unë propozoj 2 emra për zëvendëskryetarë të KB znj. Edlira Mitre dhe z.Erjon Kurti.

Këshilltar D.Osmani: Edhe unë si drejtuesi i koalicionit BF po prozoj dy emra znj. Ismeralda Dinellari dhe znj.Jorida Romaçka.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Ka propozime të tjera?

-U propozua dhe Laureta Alidinaj.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Komisioni i votimit ju lutem të përgatiten fletët e votimit. Do votohet për 3 kandidatura, nëse votohet për 4 apo 5 fleta e votimit do të jetë e pavlefshme. Nëse votohet më pak sesa 3 fleta e votimit do të jetë e vlefshme. Vijon procesi i votimit në mënyrë të fshehtë.

Komisioni i votimit: Vazhdojmë me procesin e numërimit në mënyrë transparente.

Këshilltar D.Osmani: Rregullorja që është në fuqi e KB Korçë Mars 2020, neni 20 i saj thotë, më lejoni ta citoj: Procedura e zgjedhjes për zëvendëskryetarë të këshillit pika 1, Këshilli zgjedh nga gjiri i vet të paktën 2 zëvendëskryetarë. Njëri nga zëvendëskryetarët duhet t'i përkasë partisë më të madhe të opozitës në Këshill, i cili propozohet nga këshilltarët ose Grupi i Këshilltarëve që i përkasin opozitës. Dhe në këtë rast kërkoj që votimi të ribëhet.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Unë do të sugjeroja që opozita të dilte me propozim me 1 emër sepse kështu do të shkonte procesi i votimit më mirë. Si proces është një proces i rregullt sepse të gjithë kemi votuar dhe të gjithë u dakordësuam qysh në fillim për numrin e zëvendëskryetarëve por njëkohësisht edhe për administrimin e kandidaturave. Që në momentin që u administruan kandidaturat duhet të thoshit që duhet të dilnit me 1 kandidaturë.

Këshilltar D.Osmani : Unë ju kuptoj por nuk do të thotë që ne ti dimë përmendësh të gjitha nenet.Tani mua sapo më erdhi informacioni nga kolegët dhe po lexoj rregulloren. Dhe përderisa vjen ky propozim është prishur.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Po nuk është prishur sepse ne si proces ka qënë i rregullt.

Këshilltar D.Osmani: Procesi i propozimeve.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Ju duhet të ishit dakordësuar qysh në fillim. E bëtë propozimin ju. Kam të drejtë të propozojmë edhe grupimet e tjera.

Këshilltar D.Osmani: Një nga zvkrëtarët i takon grupit më të madh opozitar.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Po kjo është me votë.

Sekretare E.Naçi: Zvkryetarët zgjidhen me votën e këshilltarëve. Sipas rregullores ju e bëtë propozimin tuaj 2 emra.

Këshilltar D.Osmani: Po e bëra dy sepse nuk e kisha informacionin që duhet vetëm 1 dhe na takonte ne.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Jo nuk është një dhe ju takon ju. Një zëvendës i opozitës.

Sekretare E.Naçi: A i bëtë ju propozimet? A ishin në fletën e votimit, tani le të votoheshe. Ligji nuk ja heq të drejtën asnjë grupimi tjetër politik të bëjë propozim. Prandaj bëhet me votim.

Këshilltare S.Dinellari: Citon sërish rregulloren. Partia opozitare më e madhe në këtë këshill është Bashkë Fitojmë. Propozimet dolën nga ne 2 propozime.

Sekretare E.Naçi: Po nuk u votuan.

Këshilltare S.Dinellari: Pjesa tjetër nuk duhet të miratohej nga ju.

Sekretare E.Naçi: Kush nuk duhej të miratohej? Nuk ja ndalon as ligji as rregullorja të bëjnë propozime.

Këshilltare S.Dinellari: Është një udhëzim që del në zbatim të ligjit neni 20 pika 1.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Të dëgjojmë dhe mendime të tjera nga këshilltarët.

Këshilltar E.Nexhipi: Pasi doli rezultati direkt u replikua, e dyta nuk diskutohet si në pazar, merr fjalën e thua mendimin ke të drejtë ankimimi por po shpjegoj procedurën që ne e kemi zbatuar 100 herë. Procedura u kalua brenda rregullit, propozimet tuaja ishin 2, doli dhe një tjetër u hodhën në votim. Këtu ka proces votimi nuk është çështja me konfirmim. Për mua të vazhdojë komisioni procedurën e përmbylljes së procesverbalit, pastaj kush nuk është dakord ka të paraqitura në rregullore mund ta lexoni deri në fund ka procedurë ankimimi.

Këshilltar D.Osmani: Unë po lexoj rregulloren e KB, nuk po them asnjë fjalë më tepër.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Në fakt rregullorja është e shpërndarë në dijenin time sepse na ka ardhur të gjithëve.

Sekretare E.Naçi: Është publike në faqen e këshillit.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Dhe mund të lexohet përpara se të vije në mbledhjen e këshillit. Gjithësesi të dëgjojmë vendimin e komisionit dhe më pas vazhdojmë me procesin e ankimimit nëse ka.

Komisioni i votimit: Nga përfundimi i votimit ne kemi bërë numërimin e votave dhe rezultati është si më poshtë :

Edlira Mitre 29 vota

Erjon Kurti 29 vota

Suela Dinellari 7 vota

Jorida Romaçka 7 vota

Laureta Alidinaj 27 vota

Gjithashtu kemi dhe një votë të pavlefshme .

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Do të thoja që në rregullore është partia më e madhe opozitare nëse e lexuat me kujdes. Bashkë Fitojmë nuk është parti është koalicion dhe përderisa është koalicion dhe rregullorja e qartëson parti politike atëhere propozuam u administruan u votuan kështu që unë e quaj procesin e vlefshëm. Nëse ka ankimime të vazhdojë me procesin e ankimimit.

Sekretare E.Naçi: Nga dita e hënë unë do ju ve në dispozicion ne emailt tuaja të gjitha rregulloret.

Këshilltare S.Dinellari: Thatë që ne jemi koalicion dhe nuk jemi një parti. Kur kandiduam kandiduam si subjekt zgjedhor me të drejta të barabarta koalicioni dhe parti, e dyta ne përfaqësojmë votën e masës më të madhe që përfaqësojnë opozitën dhe kjo nuk është aspak e drejtë. Ju mund të votoni kë të doni edhe nga partitë e tjera të vogla për zv/kryetarë edhe ju këshilltarët e tjerë por kjo tregon që nuk jeni duke respektuar vullnetin e popullit opozitar. Mund të bëheni 4,5,25 por kjo nuk tregon fare që jeni duke respektuar opozitën, atë që ju vetë e keni nënshkruar me rregulloren e brendshme të KB.

Këshilltar K.Pllaha: Mendoj se nuk ishte e drejtë fakti që cdo këshilltar ka 3 vota të vlefshme do ishte më e drejtë që çdo këshilltar të kishte një votë dhe pastaj ata kandidatë që mernin kishin të drejtë të bëheshin zv/kryetarë. Sepse duke pasur 3 vota i bie që opozita zgjedh dhe zv/kryetarin e opozitës.

Sekretare E.Naçi: Kjo gjë nuk është e mundur pasi ligji për vetëqeverisjen vendore përcakton që të zgjidhet kryetari dhe zv/kryetari duhet të ketë vota më shumë se gjysma e nr të përgjithshëm të këshilltarëve pra që do të thotë 21 që të quhet i zgjedhur.

Këshilltar P.Tollkuçi: Unë mendoj që ne të gjithë këtu përpara se të niste procesi i votimit kemi miratuar një komision i cili administron të gjithë procedurën. Kështu që ne pasi pamë këtë rezultat nuk mund të gjukojmë asnjë hap të hedhur, sepse ne nuk mund të nxjerrim rezultatin dhe të flasim, sepse flasim gjithmonë pasi del rezultati i votimit. Të gjithë dhamë dakordësim të gjithë votuam sipas ligjit në fuqi.

Sekretare E.Naçi: Ligji organik që është për vetë qeverisjen vendore nr 139 2015, neni.55 Votimi “ Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat a) b) c) d) dh) të nenit 54 të këtij ligji”. Neni 54 në shkronjën b) Zgjedh duke respektuar ligjin për barazinë gjinore kryetarët dhe zv/kryetarët e KB dhe i shkarkon ata. Pra vendimet merren me shumicën e votave të gjithë anëtarëve të këshillit.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Nëse do të vazhdojë kështu do të zgjatet.

Këshilltare K.Pllaha: Po lexoj nenin 20 të rregullores të KB pika 5: Këshilli bën votim të veçantë për secilin prej zëvendëskryetarëve. Kjo nuk është respektuar , e bën kjo të pavlefshëm votimin?

Sekretare E.Naçi: Jo nuk e bën.

Këshilltare K.Pllaha: Po nëse nuk zbatohet rregullorja.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Ne u dakordësuam që në fillim fare për procedurën e votimit dhe nuk pati asnjë kundërshtim në raport me këtë. Aty votimi i veçantë është. Ju lutem komisioni rezultatin e votimit.

Sekretare E.Naçi: Pak më parë ju të gjithë ma bëtë me shënjë ec dhe ne dakordësuam që emrat të jenë në një listë dhe do të votoheshe për 3 aq sa është nr i zv/kryetarëve. Tani partia më e madhe e opozitës nuk është BF sepse BF është koalicion nuk është parti, megjithatë propozimet u bënë sepse ligji nuk e ndalon.

Këshilltare S.Dinellari: Kualicioni BF është subjekt zgjedhor me të drejta të barabarta. Jeni duke shkelur të drejtat e opozitës dhe kjo është e padrejtë.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Unë nuk do doja të kanalizoj, ne u dakordësuam që në fillim, besoj isha e qartë për procesin e votimit. Një proces që ju e ndoqët për mënyrën se si u votua dhe nuk keni asnjë vërejtje me këtë proces. Në momentin kur administrohen rezultatet zgjedhore ju sjeni dakord sepse thoni tani e lexova rregulloren. Nuk ju ka penguar askush të lëxoni rregulloren. Po vazhduam kështu do të zgjatemi dhe nuk i japim dot zgjidhje. Do të doja që komisioni i votimit të japë rezultatin dhe më pas nëse keni probleme të tjera me mënyrën se si do ta argumentoni këtë proces bëni ankimim dhe zgjidhet ndryshe.

Komisioni i votimit: Kandidatë fitues si zv/kryetarë janë Edlira Mitre, Erjon Kurti, Laureta Alidinaj.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Vazhdojmë procesin sipas rendit të ditës. Ceremonia e marrjes së detyrës nga Kryetari i Bashkisë. Po lexoj vendimin e gjykatës. Vendim në emër të Republikës Gjykatë e Shkallës së Parë të Juridiksion të Përgjithshëm Korçë e përbërë prej gjyqtar Ervin Sulaj, asistuar nga sekretare gjyqsore Enxhi Berberi sot në datën 15.06.2023 marrim në shqyrtim në seancën gjyqsore çështjen civile nr.3 me datë rregjistrimi 07.06. 2023 që i përket kërkuar Sotiraq Filo , i biri i Melka datëlindjes 23.06.1971 lindur dhe banues në Korçë me adresën lagjia nr 2 rruga Alqi Kondi nr 36 me shtetësi shqiptare i identifikuar me letërnjoftimin 035928I34 përfaqësuar dhe në gjykim nga shtetësja Anxhela Qiramixhi me shtetësi shqiptare identifikuar me letërnjoftimin nr 036838486. Objekti vërtetimi mandatit të kryetarit të bashkisë. Baza ligjore neni 60/1 i ligjit 139 të vitit 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjykatë pasi dëgjoi kërkuar vendosi bazuar në nenin 306, 310 k) i procedurës civile dhe nenin 60 pika 1 të ligjit 139 të vitit 2015 Për vetëqeverisjen vendore Vendosi pranimin e kërkesës , kërkuar Sotiraq Filo, vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Korçë për shtetasin Sotiraq Melka Filo i zgjedhur në zgjedhjet për njësitë e qeverisjes vendore datë 14/05/2023. Po lexoj dhe formulën e betimit të kryetarit: Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e kryetarit të Bashkisë Korçë dhe do ti bindem kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interes e shtetasve të bashkisë Korçë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre. Betohem!

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Betohem! Të nderuar këshilltarë të KB, të nderuar deputetë, prefekt të nderuar kryetarë të KB, për mua është një moment shumë i veçantë që të rimar mandatin për të drejtuar bashkinë e Korçës. Është një nder dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme që të drejtosh një bashki si bashkia e Korçës, një qytet me vlera të jashtëzakonshme me trashëgimi të jashtëzakonshme si Korça dhe me një territor si bashkia e Korçës e cila i ka dhënë shumë në historinë e saj Shqipërisë. Besoj se mandati që kemi përpara është mandati i sfidave por dhe i mundësive të mëdha për të adresuar ato që janë prioritetet e punës së bashkisë, ne i kemi

përmendur këto edhe gjatë fushatës elektorale. Unë besoj se përtej arritjeve të jashtëzakonshme që Korça ka arritur vitet e fundit kemi disa sfida të mëdha përpara. Jam shumë i bindur që ky do të jetë një mandat i cili do ta çojë Korçën në një nivel të rri dhe më të lartë të zhvillimit të saj. Është një mision i çdo këshilltari që të sjellin këtu zërin e votuesve, banorëve të Korçës. Uroj dhe besoj që të gjithë sëbashku të bëjmë punë të mira në këto 4 vite që kemi përpara.

Kryetare e Këshillit Bashkiak A.Verushi: Do të doja ti jepja fjalën edhe Ministrit të Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes N.Peleshi: Kënaqësi të marr pjesë në këtë mbledhje të konstituimit të KB. Sot kam nderin që ta përfaqësoj Korcën dhe si deputet i qarkut. Unë jam shumë i kënaqur që kemi një këshill të ri bashkiak që duhet të jetë shumë vital, është i balancuar edhe nga pikëpamja gjinore ka vajza gra burra djem që përfaqësojnë të gjithë qytetin, të gjitha institucionet administrative të Korcës në këtë këshill. I sigurt jam dhe unë që ky do të jetë një parlament lokal ku do të vijë dëshira projekte mendime qofshin ato kritike të qytetarëve, banorëve të qytetit dhe fshatit të cilat pastaj do të kthehen në punë më të mira. Është një korrigjim i demokracisë lokale do të thoja ky këshill, sepse në këshillin e kaluar duhet ta themi që ka patur një handicap që ishte mos prezenca e opozitës për shkak të bojkotit. Të jemi së bashku në një mandat që do ta çojë qytetin por edhe demokracinë lokale në një nivel më të lartë. Duhet thënë që ai program që është firmosur është jashtëzakonisht ambicioz dhe i vështirë për tu realizuar, kërkon edhe mbështetje qëndrore dhe unë këtu marr rolin që më takon dhe detyrat që më takojnë por të jemi të sigurt që nesë bëhemi sëbashku edhe me opozitën këtu edhe me ata që mund të na kenë votuar kundër sepse nuk e besojnë, nesë e bëjmë realitet atë program të gjithë do të shënojmë emrin në një histori të Korcës shumë moderne dhe të rëndësishme. Le të debatojmë dhe të diskutojmë gjithmonë të frymëzuar nga interesi për Korcën. Punë të mbarë të gjithëve. Jam shumë i lumtur për Anën sepse ka një eksperiencë të gjatë në administrim, ka drejtuar për 2 mandate Këshillin e Qarkut, i njeh të gjitha problematikat e të gjitha bashkive të qarkut. Ka një ndërveprim shumë të madh me vendet kufitare, ka patur shumë aktivitete edhe me arenën ndërkombëtare. Nga ana e opozitës unë përgëzoj edhe Lazjonin edhe Klajdin që janë dy prurje të pazakonta për këshillin sepse janë dy anëtarë të KB që kanë ardhur me forcat e tyre me votën jo politike jo 100% politike, edhe kjo tregon një gjest emancipimi të bashkisë tonë. Këta dy djemtë erdhën në këshill tregon që demokracia lokale është në emancipim, kështu që le të shikojmë sot pozitiven dhe pastaj ti lemë ato çështjet për të cilat nuk biem dakord ti lemë për më vonë.

Prefekti i Qarkut Korçë N.Jole: Kjo konsiderohet edhe dita e parë formale e punës së këtij Këshilli dhe kryetarit të bashkisë ndaj me pikënisje të këtij mandati 4 vjeçar dëshiroj t'ju uroj të gjithëve shumë suksese. Secili nga ju ka detyrimin të udhëhiqet nga interesi më i mirë publik dhe ai qytetarve dhe pse jo të marrë vendime në përputhje me këtë interes. Pavarësisht punës së këtij këshilli do kisha dashur mos humbiste asnjëherë komunikimi me përfaqësuesit e komunitetit, grupet e interesit me zgjedhësit tuaj. Si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në Qark shpreh angazhimin tonë për tju mbështetur institucionalisht në mënyrë konstruktive në këto 4 vitet që vijë edhe në përputhje gjithmonë me ligjet e vendit.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Vazhdojmë me rendin e ditës. Zgjedhja e këshilltarëve që do të përfaqësojnë Këshillin e Bashkisë në Këshillin e Qarkut. Po lexoj vendimin e prefektit në përgjigje të shkresës tuaj 4052 prot datë 24.05.2023 kërkesë për dhënie informacioni prefekti i qarkut Korçë në zbatim të nenit 73 pika 3 të ligjit 139 viti 2015 Për vetë qeverisjen vendore të ndryshuar si institucion përgjegjës për caktimin e numrit të përfaqësuesve të bashkive në Këshillin e Qarkut sipas evidencave të zyrave të gjëndjes civile të datës 1 Janar të vitit



të zgjedhjeve vendore bën me dije se numri i anëtarëve të KB të Korcës është 6 përfaqësues përfshirë edhe kryetarin e bashkisë Korçë. Pra 5 këshilltarë dhe kryetari do të përfaqësojnë KB në Këshillin e Qarkut. Të fillojmë me procesin e administrimit të 5 kandidaturave. Nga komisioni i votimit kemi vetëm 2 prej anëtarëve sepse njëri është larguar. Do të doja që dy anëtarët të zenë vendet dhe do t'ju lutesha nga prezenca e këshilltarëve të opozitës që është këtu në sallë të propozojë një kandidat tjetër për procesin e votimit. Një propozim për komisionin e votimit nga prezenca e këshilltarëve.

Hidhet në votim kush është dakord për Kristiano Kocibelli.

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Këshilltar P.Tollkuçi: Në emër të Partisë Socialiste propozoj : Ada Përmeti, Erjon Nexhip, Petrika Tollkuçi, Anxhela Taho, Alma Burda.

Këshilltar L.Petri: Perpara se të vazhdoj me propozimet mendoj se është konflikt interesi që Petrika të propozojë veten.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Është kryetar grupi dhe ai flet në emër të grupit. E cila do të thotë që do të japë vendimin që ka marrë grupi në lidhje me propozimin. Megjithatë një këshilltar tjetër mund ta propozojë. Ju lutem nga këshilltarët e opozitës ka propozime?

-Propozohet nga opozita Kristi Koçibelli.

Këshilltar K.Koçibelli: Po mbaj pozicionin tim si anëtar komisioni.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Këshilltari Kristi Koçibelli ka pranuar pozicionin e tij në komisionin e votimit. Kemi propozime për kandidatura të tjera?

Këshilltare L.Alidinaj : Dua të bëj 3 propozime: Enkel Bregu, Lazjon Petri dhe Klajdi Pllaha.

Komisioni i votimit: Janë 8 kandidatura dhe nga 8 do të votohen 5 këshilltarë.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Të gjitha emrat do të vendosen në një fletë dhe ju do të zgjidhni 5 prej tyre. Fleta do të jetë e vlefshme nëse do të ketë më pak se 5 kandidatura. Fillojmë procesin e votimit.

Komisioni i votimit vazhdon procesin e numërimit. Kanë votuar 32 anëtarë.

Komisioni i votimit: Votat janë të shpërndara si më poshtë:

Ada Përmeti 27 vota

Erjon Nexhipi 26 vota

Petrika Tollkuçi 28 vota

Anxhela Taho 25 vota

Alma Burda 23 vota

Ervin Bregu 2 vota

Lazjon Petri 6 vota

Klajdi Pllaha 8 vota

Komisioni i votimit: Kemi ndonjë kontestim? Kandidatë fitues për këshillin e qarkut janë : Ada Përmeti, Erjon Nexhipi, Petrika Tollkuçi, Anxhela Taho, Alma Burda.

Kryetare e Këshillit A.Verushi: Sukses anëtarëve të bashkisë Korçë në këshillin e qarkut. Shumë shpejt do të kemi një mbledhje të KB sepse do të na duhet të formatojmë komisionet ndaj drejtuesit e grupimeve politike duhet të takohen paraprakisht këto dy ditë dhe më pas të kemi një pasqyrë të qartë të komisioneve, dakordësinë, numrin e anëtarëve dhe individët që do marrin pjesë në çdo komision. Gjithashtu do të keni një material i cili është në ndihmë të qytetarëve e cila është ndihma ekonomike ndaj dhe do ta përshpejtojmë këtë proces për ti bërë të dyja sëbashku.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**  
**ANA VERUSHI**